

Qasja e bazuar në të Drejtat e Njeriut (HRBA)ⁱ

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut është një tjetër çështje horizontale e rëndësishme për programet e KCSF-së. Kjo qasje siguron që të gjitha intervenimet të respektojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut, duke u fokusuar në fuqizimin, pjesëmarrjen, mosdiskriminimin dhe llogaridhënien. Integrimi i HRBA në të gjitha fazat e projektit tuaj është thelbësor për të adresuar nevojat dhe të drejtat e të gjithë hisedarëve, veçanërisht grupeve të marginalizuara dhe të cënueshme.

Analiza e të drejtave të njeriut përfshin ekzaminimin se si programi/projekti juaj do të ndikojë në të drejtat e grupeve të ndryshme, me një fokus të veçantë te grupet e marginalizuara dhe të cënueshme. Kjo analizë përfshin identifikimin e pabarazive të mundshme dhe siguron që programi/projekti promovon të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë pjesëmarrësve.

Disa pyetje për t'u marrë parasysh gjatë hartimit dhe zbatimit të projektit:

- A i konsideron programi/projekti të drejtat dhe nevojat e të gjithë hisedarëve, veçanërisht grupeve të marginalizuara si gratë, fëmijët dhe të rinjtë, të moshuarit, pakicat etnike, personat me aftësi të kufizuara dhe individët LGBTQ+?
- Si e promovon programi/projekti pjesëmarrjen, duke siguruar që të gjitha zërat, veçanërisht ata të grupeve të marginalizuara, të dëgjohen dhe të merren në konsideratë në proceset vendimmarrëse?
- A e adreson programi/projekti diskriminimin e mundshëm dhe promovon barazinë dhe mosdiskriminimin?
- Si e siguron programi/projekti llogaridhënien, duke ofruar mekanizma për hisedarët për të shprehur shqetësimet dhe për të kërkuar zgjidhje?
- A janë të integruara konsideratat për të drejtat e njeriut në planet e menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit të programit/projektit?
- A ka organizata juaj kapacitete për të zbatuar një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, duke përfshirë trajnimin e stafit, politikat dhe udhëzimet? Si mund të forcohet këto kapacitete?

Aspekte shtesë për t'u konsideruar për zbatimin e HRBA-së:

Fuqizimi:

- Sigurohuni që programi/projekti juaj fuqizon bartësit e të drejtave, duke i pajisur ata me njohuri, aftësi dhe mjete të nevojshme për të kërkuar të drejtat e tyre. Kjo përfshin krijimin e mundësive për grupet e marginalizuara për të marrë pjesë aktivisht dhe për të ndikuar në rezultatet e projektit.

Transparenca:

- Vendosni kanale të qarta dhe transparente të komunikimit që sigurojnë që të gjithë hisedarët të kenë qasje në informacionin relevant për programin/projektin. Kjo promovon besimin dhe mundëson pjesëmarrje të informuar.

Qëndrueshmëria:

- Hartoni programe/projekte që janë të qëndrueshme në afat të gjatë, me fokus në krijimin e ndikimeve pozitive afatgjata dhe nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm.

Konteksti dhe nevojat:

- Përshtatni ndërhyrjet tuaja me nevojat dhe kontekstin specifik të komuniteteve me të cilat punoni, duke siguruar ndjeshmëri dhe relevancë kulturore.

Ndjeshmëria ndaj konflikteve:

- Jini të vetëdijshëm për potencialin e efekteve negative të padëshiruara, veçanërisht në kontekste ku dinamika e pushtetit është në ndryshim e sipër. Përfshijeni një qasje të ndjeshme ndaj konflikteve për të identifikuar rreziqet dhe mundësitë, si dhe për të menaxhuar proceset e ndryshimit në mënyrë konstruktive dhe paqësore.

ⁱ HRBA- Human Rights Based Approach